



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:109564
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847927

KPPP.nr.709/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit IPKO Telecommunications L.L.C., me NRB:70064420, të cilin e përfaqëson Z.B., me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Universiteti i Prishtinës- Rektorati”, me seli në Prishtinë Rr.”Nëna Terezë” pn., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.704/19 të datës 23.08.2019, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Universiteti i Prishtinës- Rektorati”, me seli në Prishtinë, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.704/19 të datës 23.08.2019, i Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, për faturën me numër 0793920 të datës 31.12.2016, për pjesën e detyrimit në shumën prej 807.60 €.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Universiteti i Prishtinës- Rektorati”, me seli në Prishtinë, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.704/19 të datës 23.08.2019, i Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,111.05 €.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit IPKO Telecommunications L.L.C., me NRB:70064420, ndaj debitorit “Universiteti i Prishtinës- Rektorati”, me seli në Prishtinë, sipas urdhrit P.nr.704/19 të datës 23.08.2019 i Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj, për pjesën e detyrimit në shumën prej 807.60 €.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit IPKO Telecommunications L.L.C., me NRB:70064420, ka caktuar urdhrin P.nr.704/19 me datën 23.08.2019, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës me numër 0481518 të datës 31.01.2016, faturës me numër 0533181 të datës 31.03.2016, faturës me numër 0587487 të datës 31.05.2016 dhe faturës me numër 0793920 e datës 31.12.2016, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Universiteti i Prishtinës- Rektorati, me seli në Prishtinë, që në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 2918.65 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e arritjes për pagesë, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin për përmbartim, ndër të tjerash ka theksuar se faturat 0481518, 0587487 dhe 0533181 janë paguar, ndërsa faturën me numër 0793920 nuk e ka pranuar, dhe se të njëjtën e kanë kërkuar me datë 27.03.2017, me qëllim që e njëjta të kalkulohet nga kreditori dhe nga menaxheri i kontratës sepse muaji nuk ka qenë i plotë pasi që kontrata ka skaduar me datë 23.01.2017. Ka shtuar se nga ana e zyrtarëve të kreditorit gojarisht u janë përgjigjur se nuk po e faturojnë për gjysmë muaji, e kjo vlerë mund të jetë donacion për UP, ndërsa tani pas dy viteve e kërkon pagesën e këtyre faturave. Më tutje ka shtuar se për faturat e paguara ka dëshmi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, ndër të tjera ka deklaruar nuk qëndron pretendimi se debitori i ka paguar faturat.

Gjykata në ri procedurë duke vepruar sipas sugjerimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës Apelit të Kosovës në Aktvendimin CA.nr.1774/20 të datës 19.04.2021, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se urdhri përmbarimor me numër P.nr.704/19 të datës 23.08.2019, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas faturës me numër 0793920 e datës 31.12.2016, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti – fatura me numër 0793920 e datës 31.12.2016, nuk i plotëson kushtet ligjore, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që kjo faturë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se është dorëzuar tek debitori, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar dhe as e vulosur nga ana e debitorit dhe nuk ka provë se e njëjta është dorëzuar në ndonjë formë tek debitori, dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbarim për këtë arsye vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi Urdhrin e Përmbaruesit Privat P.nr.704/19 të datës 31.12.2016, për pjesën tjetër të detyrimit, për faktin se dokumenti i besueshëm – fatura me numër 0481518 të datës 31.01.2016, fatura me numër 0533181 të datës 31.03.2016, dhe fatura me numër 0587487 të datës 31.05.2016, në bazë të cilave është iniciuar propozimi për përmbarim, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 të LPP-së.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet nga komunikimet me poste elektronike të datës 17.07.2019, në të cilin debitori ndër të tjera e pranon pranimin e faturave si dhe pretendon se të njëjtat janë paguar.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore në këtë procedurë, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohen në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera kreditorit dhe debitorit të paraqitur, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbartimore.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.709/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.